

Shtojca 3: Lista e Shpenzimeve të Pranueshme

ZV 4 – Turizmi Rural

4.1 Investimet në fermë për aktivitetet rurale/agroturizmi

<p>4.1.01</p>	<p>Investimet që lidhen me ndërtimin/shtesat/rikonstrukcionin e ndërtesave/dhomave për akomodimin e turistëve, servirjen e ushqimit dhe pijeve freskuese, ambjentet e argëtimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Investimet në lidhje me ndërtimin, rikonstrukcionin përmes modernizimit dhe shtimit të godinave të turizmit rural (akomodim dhe ushqim), strukturat e agroturizmit dhe lloje të tjera të strukturave akomoduese të zhvilluara nga në fermer me një kapacitet prej/deri në 16 shtretër dhe nga një sipërmarrje mikro që ka deri në 25 shtretër. - Investimet në ndërtimin dhe/ose rikonstrukcionin e godinave për shërbimet e turistëve, si dhoma, tualete/banjo, kuzhina dhe ambjente të tjera që përfshijnë objekte për mbajtjen e kafshëve të synuara për qëllime turizmi, ambjente rekreacioni, kampe turistësh, rinovim i ndërtesave të vjetra (qilarë të vjetër, mullinj, etj). - Sigurimi i mobiljeve për dhoma, kuzhinë, banjo, furnizimi me ujë, ngrohje, etj, si psh. ndricimi dhe pajisjet elektroshtëpiake, pajisjet e ajrit të kondicionuar, ngrohësit e ujit, pajisjet filtruese dhe pastruese, moblijet, instalimet sanitare; - Rimodelimi i Ndërtesave – vetëm për të kthyer një ndërtesë për përdorim ekonomik ose për të ndryshuar përdorimin e ndërtesës. <u>Mirëmbajtja e një ndërtese ekzistuese nuk është e pranueshme.</u> - Ambjentet argëtuese – Struktura e akomodimit të turistëve si hapësirat e kampimit, dhe pistat e hipizmit, - Investimet që lidhen me instalimin e një boriku privat në fermë (dhe/ose pajisje/ambjent i përshtatshëm për trajtimin e ujit) në zona rurale të izoluara për t'u mundësuar aplikantëve të marrin furnizim të bollshëm me ujë aty ku aktualisht nuk është e disponueshme, dhe ku përdorimi i rrjetit të ujit publik nuk është i mundshëm teknikisht ose financiarisht. - Investimet që lidhen me përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe menaxhimit të ujërave të zeza, ndërtimin/sigurimin e pajisjeve për mbeturinat; - Krijimi i hapësirave për zgarë dhe piknik, kënde lojërash për fëmijë, ambjente për shërbime shtesë në kohën e lirë dhe zonë aventurash dhe blerja e instalimit i pajisjeve sportive dhe të lojrave për pushuesit, rrethimi me gardh, mur, etj. - Ambjentet e bar-restoranteve me ose pa akomodim duke përfshirë pajisjet dhe mobiljet për servirjen e ushqimit (tradicional).
<p>4.1.02</p>	<p>Investimet / sigurimi që lidhet me krijimin e dyqaneve në fermë për artikuj që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e turizmit në zonën e tyre si Sporte Aventure, mjetet e transportit miqësore ndaj mjedisit për të lëvizur brenda zonës së turizmit, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dyqanet me pakicë në fermë – krijimi i një dyqani të ri me pakicë ose kostot që lidhen me një dyqan ekzistues me pakicë për tregëtimin direkt të produkteve të fermës, produkteve tradicionale, artizanale janë të pranueshme vetëm në atë vend ku dyqani vetë është pjesë integrale e një ambjenti të prodhimit të punimeve artizanale ose të një dyqani ferme. Në kuadrin e kësaj ZV-je mund të financohen dyqane fermash të cilat shesin produkte të

	<p>kultivuara të zonës/qarkut dhe produkte të prodhurara (për fermerët individualë ose për prodhuesit në një grup fermerësh).</p> <p>- Dyqan në fermë për shitje/qiramarrje –Investimet në ndërtimin dhe/ose rikonstruksionin dhe /ose pajisjet për ngritjen e pikave të shitjes/qiramarrjes në fermë, si dhe sigurimin e pajisjeve sportive me qira (marshim dhe udhëtim, ciklizëm, etj).</p>
4.1.03	Teknologjia, pajisjet, ambientet për prodhimin/përpunimin e ushqimit në fermë: investime në ngritjen e (ndërtim dhe/ose rikonstruksion dhe/ose pajisje).
4.1.04	<p>Teknologjitë e energjisë së rinovueshme</p> <p>- Investimet që lidhen me teknologjitë e gjenerimit të energjisë elektrike – ndërtimin/përmirësimin në rritjen e efikasitetit të energjisë së fermës përmes pajisjeve të energjisë së rinovueshme;</p> <p>Blerja dhe instalimi i paneleve diellore, etj.</p>
4.1.05	Krijimi dhe prodhimi i fletëpalosjeve promociionale për reklamimin e aktiviteteve turistike në fermë, si botimi i parë i fletëpalosjeve, posterave, faqeve të internetit, etj., vetëm si pjesë integrale e një investimi të renditur më sipër.